

MODELI I STATUTIT

Statuti i një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar

Në përputhje me kërkesat nga neni 32 deri në 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Themeluesit e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar më dt. _____ nxjerrin :

STATUTIN

E

“ _____ ” SH.P.K.

(emërtimi i Shoqërisë)

_____ - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

(selia)

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- emërtimi i Shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare ”(emërtimi)” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shkurtimisht : ”(emërtimi)”sh.p.k.

Neni 3

LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ,shkurtimisht **SH.P.K.**

Neni 4

ADRESA E SELISË

4.1. Selia e ” emërtimi i shoqërisë ”sh.p.k. është në (adresa e shoqërisë).

4.2.**Agjent i regjistruar** i kësaj shoqërie tregtare është (emri dhe mbiemri) , i cili është agjent i ligjshëm për pranimin e shërbimeve,njoftimeve,kerkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.

3. Shoqëria mund të themelojë filiala,zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme

Neni 6

PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 7

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë është :

Shembull si me poshte :

1551 Përpunimi i qumështit dhe prodhimi i djathit

Tregtia me shumice e qumështit,produkteve te qumështit,vezëve,vajit dhe
5133 yndyrave ushqimore

5227 Tregtia tjeter me pakice e ushqimit,pijeve dhe duhanit ne dyqane te specializuara.

Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen tek Zyra e regjistrimit e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 8

THEMELUESIT E SHOQËRISË

10.1. Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik,që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë ,me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

10.2. Themelues jane :

1. Emri Mbiemri –Adresa e vendbanimit
2. Emri Mbiemri –Adresa e vendbanimit.

10.3. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë,përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e Aksionarëve.

Neni 9

TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE

11.1.Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

11.2.Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

11.3.Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

11.4.Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënjen me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

11.5. Çdo aksionar ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron .

11.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave,me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- 1.Kuvendi i aksionarëve
- 2.Drejtori apo Drejtorët Menaxhues.

Shoqëria mund të krijoj dhe mbajë edhe një Bord të drejtorëve.

Neni 11

Kuvendi i aksionarëve

13.1. Kuvendi i aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Statut.

13.2. Kuvendi i aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

Neni 12

E drejta e votës

14.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një(1) vote.

14.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi ,kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

Drejtimi i mbledhjeve të Kuvendit

15.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet :

- nëpërmes njohtimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo

- ne mënyre elektronike ne email adresat e aksionareve ku patjetër duhet konfirmimi.

15.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve ,drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.

15.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojnë personat që kane autorizim e ne pajtueshmëri me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

15.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 14

Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit

16.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe detyrimisht në fund të saj ,duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

16.2. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe në të dytën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më te largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u përkasin aksionarëve te pranishëm ose të përfaqësuar.

16.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

16.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 15

E drejta për të u njohur me dokumente

Drejtori duhet të paktën 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit të iu dërgojë dokumentet e nevojshme aksionerve për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit të kontabilitetit, raportin e Këshillit mbikëqyrës, të gjitha projekt vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 16

NËPUNËSIT E SHOQËRISË

18.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjedhen nga Drejtori. Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se dy nëpunës.

18.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

Neni 17

DREJTORI

19.1. **Drejtor i Shoqërisë** emrohet :”Emri Mbiemri- Vendbanimi” i cili do të ushtroi funksionet e tij/saj nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve.

19.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionarëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i Drejtorit ,pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 18

Kompetencat dhe kufizimet

20.1 Drejtori ka këto kompetenca:

- të paraqitet,përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq afarizmin e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerine e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin,Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

20.2. Drejtori si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidhe Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.

Neni 19

Përfaqësimi

Nga ana ligjore ,Shoqëria përfaqësohet nga drejtori.

Neni 20

NDARJA ,BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet,bashkohet,likuidohet ose transformohet në një formë tjetër,përpara afatit të përcaktuar,me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerve,në përputhje me parashikimet e “Ligjit për shoqëritë tregtare”.

Neni 21

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

24.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

24.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

24.3. Për të gjitha qështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data: _____

Vendi: _____

Themeluesit :

1.EmriMbiemri _____

2.Emri Mbiemri _____